

Emertimi i shoqërisë dhe forma ligjore : "MANE TCI" Sh.p.k.  
NIPT : K22203004A  
Adresa e selisë : Autostrada Tirane-Durres, Km. 6  
Komuna Kashar, Tirane  
Telefon : (4) 2380 124  
E-mail : [info@manetci.al](mailto:info@manetci.al)  
Data e krijimit : 25 Prill 2002  
Nr. Regjistrimit tregtar : Nr 27647  
Veprimtaria kryesore : Tregtimi i mallrave me shumicë e pakice, Import-  
Eksport, Qeradhenie, Ndertim etj, sipas objektit të  
veprimtarisë të përcaktuar në vendimin e gjykatës  
Tirane

## PASQYRAT FINANCIARE

Periudha kontabël e Pasqyrave Financiare : 01.01.2013 deri 31.12.2013  
Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare : 15.03.2014  
Pasqyrat Financiare janë individuale : INDIVIDUALE  
Pasqyrat Financiare janë të konsoliduara : TE PAKONSOLIDUARA  
Pasqyrat Financiare janë të shprehura në : LEKE  
Pasqyrat financiare janë të rrumbullkosura në : LEKE



**RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUAR**

**Drejtuar: Ortakut të shoqërisë “Mane TCI” shpk,  
Autostrada Tiranë-Durrës, km.6, Komuna Kashar  
Tiranë**

**I nderuar Zotëri,**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë “Mane TCI” sh.p.k., të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 Dhjetor 2013 dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë, për vitin ushtritor të përfunduar në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues.

**Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë edhe për shkak të mashtrimit apo gabimit.

**Përgjegjësia e audituesit**

Përgjegjësia jonë, është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare, bazuar në procedurat e auditimit. Ne e kemi kryer auditimin, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur siguri të arsyeshme për faktin, nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale. Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë kryerjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave përkatëse të entitetit, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të tij.

Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmerisë së politikave kontabël të përdorura dhe të aryetueshmërisë së çmuarjeve kontabël të kryera nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithëshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

**Opinion**

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale një pamje të vërtetë dhe të drejtë për gjendjen financiare të shoqërisë “Mane TCI” sh.p.k. me datë 31 Dhjetor 2013, për scurinë financiare të saj dhe flukset e parasë për vitin ushtritor të mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

**Venis-Audit & Financë sh.p.k.**


Vera Lala  
Ekspert Kontabël i Regjistruar

Tiranë, më 31 Mars 2014



## Pasqyra e pozicionit financiar

	Zëri i Bilancit	Shenime	Viti Ushtrimor 2013	*** Ri - Paraqitur Viti Paraardhes 2012
<b>A</b>	<b>AKTIVET</b>			
<b>I</b>	<b>Aktivët Afatgjata</b>			
<b>1</b>	<b>Investimet financiare afatgjata</b>			
a)	Aksione dhe pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara		2,956,733,753	3,057,333,893
b)	Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje			
c)	Aksione dhe letra të tjera me vlerë			
d)	Llogari / Kërkesa të arkëtueshme afatgjata		268,376,401	137,967,726
	<b>Totali</b>	<b>15</b>	<b>3,225,110,154</b>	<b>3,195,301,619</b>
<b>2</b>	<b>Aktive afatgjata materiale</b>			
a)	Toka		300,198,000	300,198,000
b)	Ndertesat (minus amortizimi)		1,123,432,499	1,186,704,078
c)	Makinë dhe pajisje (minus amortizimi)		62,159,136	35,265,107
d)	Aktive të tjera afatgjata materiale ( me vlerë kontabel)		89,652,921	87,465,565
	<b>Totali</b>	<b>16</b>	<b>1,575,442,556</b>	<b>1,609,632,751</b>
<b>3</b>	<b>Aktive biologjike afatgjata</b>			
<b>4</b>	<b>Aktivët afatgjata jomateriale</b>			
a)	Emri i mirë			
b)	Aktive të tjera afatgjata jomateriale			
	<b>Totali</b>			
<b>5</b>	<b>Kapitali aksionar i papaguar</b>			
<b>6</b>	<b>Aktive të tjera afatgjata (në proces)</b>			
	<b>TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA</b>		<b>4,800,552,710</b>	<b>4,804,934,370</b>
<b>II</b>	<b>Aktivët Afatshkurtra</b>			
<b>1</b>	<b>Mjete monetare</b>		<b>37,425,278</b>	<b>14,423,331</b>
<b>2</b>	<b>Dervativë dhe aktive financiare të tjera</b>			
	<b>Totali</b>	<b>11</b>	<b>37,425,278</b>	<b>14,423,331</b>
<b>3</b>	<b>Aktive të tjera financiare afatshkurtra</b>			
a)	Te arkëtueshme nga kliente		396,969,995	670,831,502
b)	Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme		1,189,021,166	228,850,658
c)	Aktive tatimore të shtyra		15,712,513	14,247,331
d)	Instrumente të tjera borxhi		11,918,328	26,525,622
e)	Investime të tjera financiare			
	<b>Totali</b>	<b>12</b>	<b>1,613,622,003</b>	<b>940,455,112</b>
<b>4</b>	<b>Inventari</b>			
a)	Lëndët e para	<b>13</b>	127,126,294	179,876,593
b)	Punime në proces	<b>13</b>	5,013,641,920	5,153,691,376
c)	Produkte të gatshme		-	823,977
	<b>Totali</b>		<b>5,140,768,214</b>	<b>5,334,391,946</b>
<b>5</b>	<b>Aktivët biologjike afatshkurtra</b>			
<b>6</b>	<b>Aktivët afatshkurtra të mbajtura për shitje</b>			
<b>7</b>	<b>Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra</b>	<b>14</b>	7,597,438	7,133,641
	<b>AKTIVET TOTALE AFATSHKURTRA</b>		<b>6,799,412,933</b>	<b>6,296,404,031</b>
	<b>TOTALI AKTIVEVE</b>		<b>11,599,965,642</b>	<b>11,101,338,401</b>



## Pasqyra e pozicionit financiar

	Zëri i Bilancit	Shenime	Viti Ushtrimor 2,013	*** Ri - Paraqitur Viti Paraardhes 2012
<b>B</b>	<b>PASIVET DHE KAPITALI</b>			
<b>I</b>	<b>Pasivet Afatgjata</b>			
<b>1</b>	<b>Huat afatgjata</b>			
a)	Hua , bono dhe detyrime nga qeraja financiare	20	245,053,713	568,908,535
b)	Bonot e konvertueshme			
	<i>Totali</i>		<i>245,053,713</i>	<i>568,908,535</i>
<b>2</b>	<b>Huamarrje të tjera afatgjata</b>	<b>21</b>	<b>819,467,852</b>	<b>853,541,930</b>
<b>3</b>	<b>Provizionet afatgjata</b>			
<b>4</b>	<b>Grandet dhe të ardhurat të shtyra</b>	<b>22</b>	<b>3,165,075,687</b>	<b>2,956,729,979</b>
	<b>TOTALI I PASIVEVE AFATGJATA</b>		<b>4,229,597,252</b>	<b>4,379,180,443</b>
<b>I</b>	<b>Pasivet Afatshkurtra</b>			
<b>1</b>	<b>Dervativët</b>			
<b>2</b>	<b>Huamarrjet</b>	<b>17</b>	<b>2,601,912,069</b>	<b>2,497,927,850</b>
a)	Huat dhe obligacionet afatshkurtra		1,153,176,338	653,249,219
b)	Kthimet / ripagesat e huave afatgjata		1,448,735,731	1,844,678,631
c)	Bono të konvertueshme			
	<i>Totali</i>		<i>2,601,912,069</i>	<i>2,497,927,850</i>
<b>3</b>	<b>Huat dhe parapagimet</b>	<b>18</b>		
a)	Te pagueshme ndaj furnitorëve		1,370,145,734	1,452,768,550
b)	Te pagueshme ndaj punonjësve		135,448	31,387
c)	Detyrimet tatimore		106,911,230	2,460,773
d)	Hua të tjera		17,483,287	68,212,068
e)	Parapagimet e arkëtuara		6,808,564	540,957,113
	<i>Totali</i>		<i>1,501,484,262</i>	<i>2,064,429,891</i>
<b>4</b>	<b>Grandet dhe të ardhurat e shtyra</b>	<b>19</b>	<b>7,558,160</b>	<b>4,900,140</b>
<b>5</b>	<b>Provizionet afatshkurtra</b>			
	<b>TOTALI I PASIVEVE AFATSHKURTRA</b>		<b>4,110,954,490</b>	<b>4,567,257,881</b>
	<b>TOTALI I PASIVEVE</b>		<b>8,340,551,742</b>	<b>8,946,438,324</b>
<b>III</b>	<b>Kapitali</b>			
<b>1</b>	<b>Aksionet e pakicës (vetem per pasq.fin.të kosoliduara)</b>	<b>23</b>		
<b>2</b>	<b>Kapitali që i përket aksionerëve të shoqërise mëmë (vetem per pasq.fin.të kosoliduara)</b>	<b>24</b>		
<b>3</b>	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>25</b>	<b>689,750,000</b>	<b>689,750,000</b>
<b>4</b>	<b>Primi i aksionit</b>			-
<b>5</b>	<b>Njësité ose aksionet e thesarit ( negative)</b>			-
<b>6</b>	<b>Rezerva statusore</b>			-
<b>7</b>	<b>Rezerva ligjore</b>	<b>26</b>	<b>756,000</b>	<b>756,000</b>
<b>8</b>	<b>Rezerva të tjera</b>	<b>27</b>	<b>1,589,261,274</b>	<b>1,218,130,506</b>
<b>9</b>	<b>Fitimet e pashpërndara</b>		<b>(124,867,198)</b>	<b>(124,867,198)</b>
<b>10</b>	<b>Fitimi (humbja) e vitit financiar</b>	<b>28</b>	<b>1,104,513,824</b>	<b>371,130,768</b>
	<b>TOTALI I KAPITALIT</b>		<b>3,259,413,899</b>	<b>2,154,900,076</b>
	<b>TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>11,599,965,642</b>	<b>11,101,338,400</b>



Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

PËRSHKRIMI	Shenime	Viti Ushtrimor 2013	Viti Paraardhës 2012
Shitjet neto	3	2,730,263,826	2,546,137,092
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë shfrytëzimit	4	79,197,159	93,033,162
<b>Totali I te ardhurave</b>		<b>2,809,460,985</b>	<b>2,639,170,254</b>
Kostoja e mallrave dhe shërbime te shitura	5	(1,212,212,640)	(1,793,454,144)
<b>Fitimi ( humbja) bruto</b>		<b>1,597,248,345</b>	<b>845,716,109</b>
Kostot e shpërndarjes		-	-
Sherbime	6	(23,159,914)	(65,319,189)
Tatim taksa	6	(52,460)	
Te tjera shpenzime operative	6	(30,465,828)	
Shpenzime të personelit	7	(99,343,168)	(105,564,110)
Rënia në vlerë (zhvlerësimi) dhe amortizimi	8	(94,444,344)	(93,399,754)
<b>Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>1,349,782,631</b>	<b>581,433,057</b>
Të ardhura dhe shpenzime financiare nga njesitë e kontrolluara		-	-
Të ardhura dhe shpenzime nga investime në sipërmartje		-	-
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata		-	-
Të ardhurat dhe shpenzimet Financiare neto	9	(91,759,634)	(153,050,395)
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit	9	(14,242,046)	(14,354,247)
<b>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare</b>		<b>(106,001,680)</b>	<b>(167,404,641)</b>
<b>Fitimi ( humbja) para tatimit</b>		<b>1,243,780,951</b>	<b>414,028,416</b>
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 10 %	10	(139,267,127)	(42,897,648)
<b>Fitimi ( humbja) neto e vitit financiar</b>		<b>1,104,513,824</b>	<b>371,130,768</b>
Te tjera te ardhura gjithepershires		(124,111,198)	(124,111,198)
<b>Totali i Humbjeve gjithepershires</b>		<b>980,402,626</b>	<b>247,019,570</b>

Drejtor i përgjithshëm

Arben MEMO



Drejtor i departamentit të financës

Elisabeta HAJRULLAI

**Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare**
*Sipas metodës indirekte*

ne leke

	Viti Ushtrimor 2013	Viti Paraardhës 2012
<b>Fluksi parave nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		
Fitimi para tatimit	1,243,780,951	414,028,416
Rregullimet për :		
Amortizimin	94,444,344	93,399,754
Të ardhura nga investimet		
Të ardhura nga interesat	(9,092,838)	(19,043,396)
Shpenzime për interesa	97,216,416	167,926,417
(Rritje) /rënie në tepricën e kërkesave të arketueshme nga aktiviteti,	(803,575,565)	(416,223,737)
(Rritje) /rënie në tepricën e inventarit	193,159,936	(1,225,753,542)
(Rritje) / rënie në tepricën detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti	(560,287,609)	1,377,472,719
Paratë e perftuara nga aktivitetet		
Interesi i arkëtuar / (paguar)	(97,216,416)	(167,926,417)
Tatim fitimi i paguar	(139,267,127)	(42,897,648)
Paraja neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	<b>19,162,091</b>	<b>180,982,565</b>
<b>Fluksi i parave nga veprimtaritë e investuese</b>		
Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara	100,600,140	
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(96,278,263)	(19,673,485)
Të ardhura nga shitja e paisjeve	36,024,114	17,812,432
Interesi i arkëtuar	9,092,838	19,043,396
Dividendët e arkëtuar		
Paraja neto, e perdorur në aktivitetet e investuese	<b>49,438,829</b>	<b>17,182,343</b>
<b>Fluksi i parave nga veprimtaritë e financiare- Cash flows from financing activities</b>		
Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar		
Te ardhura nga huamarrje	115,466,750	357,844,900
Pagesat e detyrimeve të huave / qirasë financiare	(161,065,723)	(576,769,843)
Dividendë të paguar		
Para neto e perdorur në aktivitetet financiare	<b>(45,598,973)</b>	<b>(218,924,943)</b>
<b>Rritja / (renia) neto e mjeteve monetare</b>	<b>23,001,947</b>	<b>(20,760,035)</b>
<b>Mjete monetare në fillim të periudhës kontabel</b>	<b>14,423,331</b>	<b>35,183,366</b>
<b>Mjete monetare në fund të periudhës kontabel</b>	<b>37,425,278</b>	<b>14,423,331</b>



**"MANE TCI "SH.P.K**

**4.PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL PËR VITIN QË MBYLLET MË 31 DHJETOR 2013**

b) ne një pasqyrë të pakonsoliduar

							Ne lekë
<b>Pasqyra e ndryshimeve te Kapitalit</b>	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione të thesarit	Rezerva statusore dhe ligjore	**Fitim i pashpërndarë ( Ri - paraqitur)	Totali i Kapitaleve të veta (Ri - paraqitur)	
<b>Pozicioni më 31 Dhjetor 2011</b>	<b>689,750,000</b>	-	-	<b>1,076,939,841</b>	<b>141,946,666</b>	<b>1,908,636,506</b>	
Fitimi neto i vitit financiar					371,130,768	371,130,768	
Dividendët e paguar						-	
Sistemim Fitim/Humbja e pashpërndarë					(128,225,983)	(128,225,983)	
Rritje e rezervës së kapitalit					3,358,785	3,358,785	
Emetimi i aksioneve						-	
<b>Pozicioni më 31 Dhjetor 2012</b>	<b>689,750,000</b>	-	-	<b>1,076,939,841</b>	<b>388,210,235</b>	<b>2,154,900,076</b>	

							Ne lekë
<b>Pasqyra e ndryshimeve te Kapitalit</b>	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione të thesarit	Rezerva statusore dhe ligjore	Fitim i pashpërndarë	Totali i Kapitaleve të veta	
<b>Pozicioni më 31 Dhjetor 2012</b>	<b>689,750,000</b>	-	-	<b>1,076,939,841</b>	<b>388,210,235</b>	<b>2,154,900,076</b>	
Fitimi neto i vitit financiar					1,104,513,824	1,104,513,824	
Dividendët e paguar						-	
Rritje e rezervës së kapitalit						-	
Emetimi i aksioneve						-	
<b>Pozicioni më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>689,750,000</b>	-	-	<b>1,076,939,841</b>	<b>1,492,724,059</b>	<b>3,259,413,900</b>	



## 1. Informacion i pergjithshem

### 1.1. Statusi i Shoqerise

**Shoqeria "MANE T C I" Sh.p.k.** eshte krijuar me date 25 Prill 2002 me Vendim te Gjykates se Shkalles Pare Tirane me Nr. 27647 dhe eshte regjistruar ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne te njejten dite, me kapital te nenshkruar prej 500.000 leke, i cili eshte rritur ne vite dhe me 31.12.2013 eshte 689,750,000 leke.

Deri ne Janar te vitit 2009 ortak i vetem i shoqerise ka qene Z. Samir Mane. Me pas, aksionet e kapitalit i kaluan shoqerise BALFIN Shpk me NIPT K72223031K me ortak te vetem zotin Samir Mane.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte: Ndertimi, investimi ne prona te paluajtshme, qeradhenia, tregtimi i mallrave me shumice e pakice, import-eksport, etj, sipas objektit te veprimtarise te percaktuar ne vendimin e gjykates Tirane.

Deri me 31 Dhjetor te 2013 administrator i shoqerise eshte Z. Arben MEMO. Numri mesatar i punonjesve me 31 Dhjetor 2013 ishte 110, krahasuar me 121 qe ishte me 31.12.2012

## 2. Politika te Rendesishme Kontabile te Aplikuara

Politikat kontabile te ndjekura ne respektimin e ceshtjeve te cilat jane konsideruar materiale ne rezultatin vendimtar te vitit dhe ne paraqitjen e situates financiare te shoqerise jane si me poshte:

### 2.1 Bazat e Pergatitjes

Pasqyrat financiare te vitit 2013 jane pergatitur ne baze te Standardeve Nderkombetare te Raportimit Financiar ("IFRS"), ndersa per periudhat e meparshme raportimet jane kryer sipas SKK.

### 2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne baze te koston historike.

### 2.3 Monedha funksionale dhe prezantuese

Pasqyrat financiare te Shoqerise jane pergatitur ne Lek shqiptar ("Lekë"), e cila eshte edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik, ku operon Shoqeria (shiko gjithashtu shenimin 3.a)

### 2.4. Ndryshimet ne Politikat Kontabel

Deri me 31.12.2007 shoqeria ka zbatuar politikat kontabel bazuar ne ligjin Nr. 7661 date 19.11.1993 "Per kontabilitetin". Duke filluar nga 01.01.2008 deri ne 31 Dhjetor 2012 shoqeria ka ndryshuar politikat e saj kontabel dhe, sipas nenit 4 te Ligjit Nr. 9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ndertimi i pasqyrave financiare behej sipas Standarteve Kombetare Kontabel te Shqiperise (SKK), te shpallura me Urdherin e Ministrit Financave Nr. 4292, date 15.06.2006 dhe ndryshuar me Urdherin e Ministrit te Financave Nr. 3 date 10.01.2012

Ne vitin 2013 shoqeria ka permbushur kriteret per te zbatuar Standartet Nderkombetare te kontabilitetit, bazuar ne vendimin e Keshillit te Ministrave nr 742 date 07.11.2007, i cili ka hyre ne fuqi ne date 01.01.2008, Jane plotesuar kushtet si me poshte

- Tejkalmimi per dy vitet e fundit te kufijve a) te ardhurat vjetore 1,250,000,000 b) numri mesatar i te punesuarve mbi 100 punonjes ne vite.



**2.5- Efektet e ndryshimit te politikës kontabel**

Si pasoje e ndryshimeve te standarteve te aplikuara Shoqëria është prekur nga riklasifikime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2012, Ne baze te SNK 1, shoqëria nuk ndryshon bilancin e 2012, por paraqet hapjen ne date 1 janar 2013 te rivleresuar sipas SNK, si rezultat dhe në përputhje me SNK 8 – “Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet” keto ndryshime jane reflektuar nga rivleresimi i bilancit te mbylljes ne 31 Dhjetor 2012 me objektiv kryesor paraqitjen e pasqyrave financiare ne baze te standarteve te aplikuara, ne lidhje me matjen dhe dhenien e informacioneve shpjeguese te elementeve te perfshire ne pasqyrat financiare.

- **Riparaqitja e Bilancit 31 Dhjetor 2012**

1. Ndryshime e reflektuara ne Inventaret

1.a) Reduktimi Inventarit si rezultat i marzhit te fitimit te aplikuar nga shoqëria

Ne vitit 2013 shoqëria ndyshoje politiken e saj kontabel per trajtimin e Inventareve. Ne baze te standartit te aplikuar SNK 2 Inventaret, per njohjen e Inventareve kostot e krijimit te inventareve perfshijne te gjitha kostot e blerjes, kostot e transformimit dhe kosto te tjera te ndodhura per sjelljen e inventareve ne vendodhjen dhe gjendjen aktuale. Shpenzimet e pergjithshme administrative qe nuk atribuojne ne sjelljen e inventareve ne vendodhjen dhe kushtet aktuale njihen ne shpenzime ne periudhen ne te cilen kryen. Gjithashtu kostot e inventarit nuk duhet te perfshijne marzhin e fitimit qe shoqëria aplikon per sherbimin e ofruar per realizmin e ketij inventari. (si rezultat I zbatimit te standartit fiscal per dokumentimin e situacioneve te ndertimit).

Ne periudhat paraardhese shoqëria Marzhin e fitimit e ka kapitalizuar ne vleren e produktit ne proces, duke e njohur ate dhe ne rezultat te periudhes kontabel. Aplikimi i SNK 2 ndikon ne uljen e vleres se Inventareve per projektet te cilat jane ne proces aktualisht, per marzhin e fitimit te perfitur nga shoqëria gjate periudhes deri ne 31.12.2012. Ky ndryshim ndikon ne reduktimin e fitim humbjes se pashperndare dhe ne krijimin e nje aktivi tatimor te shtyre, pasi shoqëria ka paguar detyrimet tatimore (tatim fitimi) per prodhimin e inventareve ne periudhat para vitit 2012 dhe rabi kete baze ka te drejte te rikuperoje kete aktiv tatimor kur te ndodhe shitja e inventareve

Ne Postet e bilancit ne 31 Dhjetor 2012, ky ndryshim reflektohet si me poshte;

	<b>31 Dhjetor 2012</b>
<b>Efektet e aplikimit te SNK 8 dhe SNK 2</b>	<b>*** Ri - Paraqitur</b>
Reduktim i Investimi ne proces	142,473,314
Krijimi i nje aktivi tatimor te shtyre	(14,247,331)
Reduktimi i Fitimeve te pashpërndara	(128,225,982)

1.b) Ritja e vleres se inventareve si rezultat i riklasifikimit

Gjate viteve paraardhese shoqëria shpenzimet e tjera te realizuara per inventaret perkatesishte per Blerje Toke, Projektim, leje tarifa dhe kosto te tjera qe atribuojne ne realizimin e aktivitetit kane qene te perfshira ne postin “Parapagime dhe Shpenzime te shtyra”. Ne baze te SNK 2 keto shpenzime duhet te klasifikohen ne zerin Inventare.

	<b>31 Dhjetor 2012</b>
<b>Riklasifikimi nga Parapagime dhe Shpenzime te shtyra:</b>	<b>*** Ri - Paraqitur</b>
Shpenzime per investimin Ambasador 2	(1,320,715,202)
Shpenzime per investimin Vilat Lunder	(116,072,167)
Shpenzime per investimin Vilat Lunder	(1,172,705,106)
Shpenzime per investimin New Born Hamallaj	(31,937,929)

Si rezultat i ndryshimeve te mesiperme posti i Inventareve ne 31.12.2012 paraqitet si me poshte:

	<b>31 Dhjetor 2012</b>
<b>Riklasifikim ne Inventare</b>	<b>*** Ri - Paraqitur</b>
Punime ne proces Projekti Ambasador 2	494,949,462
Punime ne proces Projekti Vilat Lunder	4,626,803,985
Punime ne proces Projekti te reja	31,937,929
<b>Total</b>	<b>5,153,691,376</b>

## 2. Riklasifikimi i parapagimeve ndaj Furnizuesve

Shoqeria Mane TCI ka vendosur ti riklasifikojë parapagimet e realizuara ne postin "Te drejta per tu arketuar". Politika e re preferohet per arsye se ajo eshte e perputhje me SNK 39 dhe me SNK (nuk permbush kushtet per inventar), dhe i ben pasqyrat financiare te shoqerise me mire te krahasueshme.

	<b>31 Dhjetor 2012</b>
Riklasifikimi nga Parapagesa per Furnizime	<b>*** Ri - Paraqitur</b> (60,099,045)
Klasifikohen ne Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme	60,099,045

## 3. Kostot e tjera te huamarrjes.

Ne baze te SNK 39 kostot e tjera qe ka kryer shoqeria ne lidhje me fondet e huamarrjes njihen ne kosto te huamarrjes dhe shpemdahen ne baze te normes efektive te interesit gjate gjithë periudhe se kredise ose ne menyre lineare(sikurse ka vepruar shoqeria) pasi efekti I tyre ne normen e interesit efektin nuk eshte I rendesishem. Ne vitin e 2012 keto kosto rezultonin te perfshira ne Parapagime dhe shpenzime te shtyra.

	<b>31 Dhjetor 2012</b>
<b>Riklasifikimi nga Parapagime dhe Shpenzime te shtyra:</b>	<b>*** Ri - Paraqitur</b> 3,951,081
<i>Klasifikohet ne Hua , bono dhe detyrime nga qeraja financiare</i>	(3,951,081)

## 3. Shenime per zerat (elementet) e Pasqyrave Financiare Kryesore

### PASQYRA TE ARDHURA DHE SHPENZIME

Te ardhurat jane njohur me vleren e drejte te shumes se arketueshme. Ato perfshijne vleren e faturave (duke i zbritur: TVSH, zbritjet e cmimit dhe kthimet) per shitjen e mallrave, produkteve, sherbimeve. Arketimet jane kryer ne menyre te arsyeshme dhe priten te arketohen diferencat e mbetura. Te ardhurat ashtu edhe shpenzimet e shoqerise per vitin ushtrimor raportues jane kontabilizuar sipas metodes se konstatimit te te drejtave dhe detyrimeve, qe do te thote se kontabilizimi eshte bere ne momentin kur transaksioni ekonomik ndikon mbi aktivet neto te shoqerise, dhe jo ne momentin e hyrjes ose daljes se parave qe shoqerojne transaksionin.

Shpenzimet jane njohur me vleren e drejte te shumes se paguar ose te pagueshme. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare jane bere te njohura si te ardhura dhe shpenzime ne pasqyren e te ardhurave sipas rrjedhjes tyre.

### 3. Shitjet Neto

Posti i shitjeve neto te shoqerise eshte i detajuar si me poshte:

**31 Dhjetor 2013    31 Dhjetor 2012**

<b>3 Shitje neto</b>	<b>2,730,263,826</b>	<b>2,546,137,092</b>
a) Shitje produkt i gatshem	2,218,134,845	220,888,200
- Rimarrje e kostove te produktit te gatshem	(1,318,580,172)	(39,963,190)
b) Dorezim punime e sherbime	1,454,097,940	1,954,405,973
c) Qera	379,187,271.37	380,505,243
- Rimarrje e te ardhurave nga qerate	(24,882,901)	(27,887,186)
d) Reklama	-	2,256,370
e) Materiale e furnitura	13,052,324	54,895,447
f) Shitje AAM	22,151,596	17,812,432
- Vlera kontabel neto e AAM te shitura	(12,897,077)	(16,776,197)

Shoqeria ne fund te vitit 2013 ka bere njohjen e shitjeve per dorezimin e njesive ne projektet Ambasador 2 dhe Rolling Hills. Ne kete njohje, shoqeria eshte bazuar si me poshte:

- Klientet kane hyre ne objektet e tyre dhe kane te drejta te plota perdorimi mbi to

-Klientet kane paguar pjesen me te madhe te cmimit te blerjes

-Njohja eshte bere per vleren e plote te cmimit te kontrates se premtim shitjes ose te shitjes, per periudhen deri ne daten e mbylljes se pasyrave financiare me date 15 Mars 2014.

Te ardhurat nga produkti i Gatshem jane;

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>Shitje Produkt i gatshem</b>	<b>899,554,673</b>	<b>216,636,010</b>
- Total Shitje produkt i gatshem	2,218,134,845	256,599,200
Ambasador 2	1,549,311,959	143,491,473
Rolling Hills	667,998,910	
Ambasador 1	823,976	113,107,727
- Total Rimarrje e kostove te produktit te gatshem	(1,318,580,172)	(39,963,190)
Kosto produkt i gatshem Ambasador 2	(705,549,874)	(39,963,190)
Kosto produkt i gatshem Rolling Hills	(612,206,322)	
Kosto produkt i gatshem Ambasador 1	(823,976)	

4. Te ardhura te tjera nga shitja e inventareve jane:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>4 Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit</b>	<b>79,197,159</b>	<b>93,033,162</b>
a) Te ardhura te tjera	231,240,833	93,028,776
- Rimarrje e te ardhurave nga sherbimet operacionale	(53,016,268)	0
- Rimarrje e te ardhurave nga shitja e kuotave TEG	(100,600,140)	0
b) Kamat vonesa nga qerate	1,572,734	4,386

5. Posti i Mallrave, Lendet e para dhe Sherbimet eshte i detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>5 Mallra, lendet e para dhe sherbimet</b>	<b>1,212,212,640</b>	<b>1,793,454,144</b>
Ndryshimi I gjendjes Prod. Gatshem & kosto e Materialeve		
a) te par ate harxhuara	1,072,209,371	1,679,227,173
b) Sherbime nga trete	133,782,160	109,203,265
c) Prime sigurimi	3,658,165	3,968,804
d) Reklama / marketingu	2,562,945	1,054,903

6. Shpenzimet e tjera nga veprimtarite e shfrytezimit jepen me detaje si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>6 Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytëzimit</b>	<b>53,678,201</b>	<b>65,319,189</b>
a) Transferim udhëtim e diëta	19,599,029	12,679,212
b) Shpenzime telekomunikimi dhe poste - Rimarrje e shpenzimeve te telekomunikacionit	2,272,091 (1,035,508)	5,914,117 (1,403,301)
c) Shpenzime logjistike	18,411,472	16,217,592
d) Shërbime bankare	838,923	858,812
e) Te tjera tatim taksa	52,460	9,776,640
f) Shpenzime per pritje e dhurata	5,769,340	2,679,350
g) Penalitete, gjoba, demshperblime	3,021,953	472,011
l) Te tjera shpenzime rrjedhese	4,748,442	18,124,756

7. Shoqëria per vitin ushtrimor 2013 ka kryer shpenzime per personelin e saj sipas zerave perkates:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>7 Shpenzime te personelit</b>	<b>99,343,168</b>	<b>105,564,110</b>
a) Pagat	87,527,814	92,748,045
b) Sigurime shoqërore	11,815,354	12,816,065

8. Shoqëria nuk ka konstatuar ndonje tregues per zhvlerësimin e AAM-ve prandaj nuk jane kryer ndryshime ne vlerat e regjistruara per to. Si rrjedhim, ky post detajon vetem amortizimin e akumuluar per AAM-te ne fund te vitit ushtrimor

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>8 Renie ne vlerë (zhvlerësimë) dhe amortizime</b>	<b>94,444,344</b>	<b>93,399,754</b>
a) Amortizimi i AAM	94,444,344	93,399,754

9. Vlera neto e te ardhurave dhe shpenzimeve financiare rrjedh nga shpenzimet neto per interesat e huave bankare/qirave financiare, shpenzime te tjera financiare dhe efektet e kursit te kembimit.

Veprimet ne valuta te huaja ne te gjitha llogarite e bilancit dhe te pasqyres Fitim/Humbje jane regjistruar ne („LEKË“) duke perdorur kurset e dates respektive te veprimeve/transaksioneve. Me date 31 Dhjetor 2013 eshte bere rivlerësimi i te gjitha llogarive te bilancit duke perfshire llogarite e arkave, bankat, furnitoret, klientet dhe llogarite e tjera te librit te madh duke perdorur kurset zyrtare te Bankes se Shqiperise ne kete date. Ato jane:

- 1 EUR = 140.2 leke
- 1 USD = 101.86 leke

Diferencat e realizuara nga luhatja e Lekut shqiptar („LEKË“) dhe kurseve te kembimit jane regjistruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve te vitit ushtrimor.

Me poshte jepen detajimet e ketij posti:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>9 Te ardhura dhe shpenzime financiare</b>	<b>(106,001,680)</b>	<b>(167,404,641)</b>
<b>1 Te ardhura dhe shpenzime nga interesi</b>	<b>(88,123,578)</b>	<b>(148,883,021)</b>
a) Te ardhura nga interesi	9,092,838	19,043,396
b) Shpenzime per interesa	(97,216,416)	(167,926,417)
<b>2 Fitim (Humbje) nga kursi i kembimit</b>	<b>(14,242,046)</b>	<b>(14,354,247)</b>
a) Te ardhura nga konvertimi	-	9,989
b) Humbje nga konvertimi	(14,242,046)	(14,364,235)
<b>3 Shpenzime te tjera financiare</b>	<b>(3,636,056)</b>	<b>(4,167,374)</b>

10. Shpenzimi i tatimi fitimi i llogaritur per vitin ushtrimor 2013 bazohet ne detyrimin per tatim fitimin sipas Legjislacionin Fiskal ne Shqiperi. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per vitin 2013 eshte 10%. I njejeti nivel taksimi per fitimin eshte zbatuar dhe ne vitin 2012. Ne vlere nominale, tatim fitimi i llogaritur per vitin ushtrimor eshte 139.267.127 leke. Per vitin ushtrimor shoqeria rezulton me nje fitim neto te realizuar ne vleren 1,104,513,824 leke.

Me poshte jepet detajimi i llogaritjes se tatim fitimit:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>10 Shpenzim Tatim Fitimi</b>	<b>139,267,127</b>	<b>42,897,648</b>
Te ardhura Total	4,329,565,889	2,744,253,512
Shpenzime Total	3,085,784,939	2,330,225,096
Fitim (Humbja) para tatimit	1,243,780,951	414,028,416
Minus Shpenzime te Panjohura Fiskale	(135,703,683)	(14,948,067)
Shtohen te Ardhurat e stornuar per efekt aplikimi IFRS	(13,186,636)	
Fitim (Humbja) fiskale para tatimit	1,392,671,270	428,976,483
<b>Tatim Fitimi 10%</b>	<b>139,267,127</b>	<b>42,897,648</b>
Fitim (Humbja) Neto	1,104,513,824	371,130,768

## BILANCI KONTABEL

### A. AKTIVET

11. **Mjetet monetare.** Aktivet monetare jane mjetet shume likuide qe shoqeria ka gjendje ne arke dhe banke (llogari rrjedhese). Ne paraqitjen e tyre ne bilanc ne fund te vitit ushtrimor ato jane te vleresuara dhe paraqitura me vleren e tyre te drejte.

Ne bilancin kontabel te vitit 2013, gjendjet e aktiveve monetare ne fund te vitit ushtrimor jane te detajuara si me poshte :

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>11 Mjetet monetare</b>	<b>37,425,278</b>	<b>14,423,331</b>
<b>a) Vlera ne arke</b>	<b>6,392,853</b>	<b>873,596</b>
a.1 - Vlera ne leke ne arke	3,729,219	110,893
a.2 - Vlera ne euro ne arke	2,663,633	762,703
<b>b) Vlera ne banke</b>	<b>24,613,011</b>	<b>4,876,890</b>
b.1 - Vlera ne lek ne banke	15,095,053	2,909,388
b.2 - Vlera ne euro ne banke	9,517,958	1,967,502
<b>c) Vlera te tjera</b>	<b>6,419,415</b>	<b>8,672,845</b>
- Letra me vlere ne arke vlere Neto	6,419,415	8,672,845

**12. Aktive te tjera financiare afatshkurtra.**

Gjendjet e aktive te tjera financiare afatshkurtra, ne fund te vitit ushtrimor jane vleresuar dhe paraqitur me vleren nominale te shumes per t'u arketuar e cila perfaqeson detyrimet e klienteve dhe te treteve ndaj shoqerise. si me poshte:

Aktivitet e tjera financiare perbehem si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>12 Aktive te tjera Financiare Afatshkurtra</b>	<b>1,613,622,003</b>	<b>940,455,113</b>
12.a) Kliente	396,969,995	670,831,502
12.b 2) Debitore te tjere	1,172,043,323	207,473,184
b.1 - Te trete	37,308,130	39,593,666
b.2- Kliente - fatura te paderguara	2,056,600,063	107,780,473
b.3- Parapagime te arketuara	(966,948,566)	0
b.4- Parapagime per furnizime	28,709,599	60,099,045
b.5- Te drejta nga Palet e lidhura	16,374,097	0
12. b1) Të drejta nga shteti	16,977,843	21,377,474
c.1- Njohja e te drejtes te fituar TVSH e zbritshme	16,977,843	3,547,622
c.2 - Tatim fitimi i parapaguar	0	243,707
c.3 - Provizione tatimore	0	17,586,145
12. c) Aktive Tatimor i shtyre	15,712,513	14,247,331
Fitimi i krijuar nga krijimi I Inventareve	(141,412,619)	(128,225,982)
Reduktimi I Inventareve per efekt te fitimit	157,125,132	142,473,314
12. d) Instrumente te tjera borxhi	11,918,328	26,525,622
- Huadhenie	11,918,328	26,525,622

**13. Inventari.**

Gjendjet e inventareve te shoqerise ne fund te vitit ushtrimor jane vleresuar dhe paraqitur ne bilancin kontabel me metoden e kosos mesatare te ponderuar te kostove te marrjes per materialet. Drejtimi i shoqerise nuk ka ndermarre rivleresime te vlerave te inventareve.

Ne zerin prodhim ne proces paraqiten te gjitha kostot per investime ne proces per projektin Vilat Lunder ne shumen 4,976,847,823 lek, vleresuar me metoden e identifikimit specifik Projekti Vilat Lunder eshte investim per shitje ne te ardhmen. Objekti Amsador 2 ka perfunduar ndertimin ne Dhjetor 2012 dhe eshte realizuar njohja e plote te te ardhurave te perfituara nga ky projekt gjate vitit ushtrimor 2013 (konfirmuar rezultatet nga kontrolli tatimori i plote i kryer ne shoqeri ne Mars 2014).

Me poshte jepet detajimi i ketij postit te Inventarit ne date 31 Dhjetor 2013:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>13 Inventari</b>	<b>5,140,768,214</b>	<b>5,334,391,945</b>
a) <b>Lendet e para</b>	<b>127,126,294</b>	<b>179,876,593</b>
Materiale te para	126,613,361	137,426,626
Inventar i imet	512,932	42,449,967
b) <b>Punime ne proces</b>	<b>5,013,641,920</b>	<b>5,153,691,376</b>
Projekti Ambasador 2 (331.f00)	-	494,949,462
Projekti Vilat Lunder	4,976,847,823	4,626,803,985
Projekti te reja	36,794,098	31,937,929
c) <b>Produkte te gatshme</b>	-	<b>823,976</b>

Ne te cilen perfshihen te gjitha kostot e drejteperdrejta te cilat ndikojne ne sjelljen e produktit ne gjendjen aktual. Ne te perfshihen:

Inventaret perbehen nga:	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Toka	977,551,748	1,170,770,966
Projektimi	82,654,860	86,143,449
Leje,Tarifa,Taxe	53,229,031	52,195,849
Ndertimi	4,045,726,475	3,975,449,488
Te tjera +	11,604,939	11,604,939
Efekti I implikimit IFRS	(157,125,132)	-
<b>TOTALI</b>	<b>5,013,641,920</b>	<b>5,296,164,690</b>

#### 14. Parapagime dhe shpenzime te shtyra.

Ne bilancin kontabel te vitit 2013, shoqeria ka gjendje ne fund te vitit ushtrimor Parapagime dhe shpenzime te shtyra ne vleren 7,597,438 lek. Ato perfaqesojne:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>14 Parapagime dhe Shpenzime te shtyra</b>	<b>7,597,438</b>	<b>7,133,641</b>
e) Shpenzime te tjera te shtyra	2,599,719	2,631,926
f) Te ardhura te llogaritura	4,997,719	4,501,715

#### 15. Investime financiare afatgjata materiale.

15.a. Aksione dhe pjesemarrje te tjera ne njesi te kontrolluara.

Ne bilancin kontabel te vitit 2013, shoqeria ka gjendje ne fund te vitit ushtrimor Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje me vleren totale 2,956,733,753 lek qe detajohen si me poshte:

15.a Emri i kompanise se kontrolluar	% Zoterimit	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
1) Skenderbej Shpk	100%	69,400,000	69,400,000
3) Tirana East Gate Shpk	87.80%	2,887,333,753	2,987,933,893
<b>Totali</b>		<b>2,956,733,753</b>	<b>3,057,333,893</b>

Gjate vitit 2013 shoqeria ka patur ndryshime ne perqindjen e zoterimit tek kompanite e kontrolluara krahasuar me mbylljen e vitit 2012. Shoqeria ne ManeTCI me ane te kontrates se shitjes date 05/04/2013 ka shitur 3.293 % te

kuotave ne kompanine Tirana East Gate perkundrejt vleren 100,600,140. Si rezultat perqindja ne kapital ishte 91,095% u be 87.8%.

Ne date 30 Shtator 2011, shoqeria Kune Biopark e zoteruar 100% nga Mane TCI ka filluar procedurat e likuidimit sipas legjislacionit perkates. Shoqeria ka njohur ne humbje te periudhes financiare te citit 2012 vleren e investimit ne kete kompani ne vleren 10,698,356.40 lek perfshire vleren e kapitalit themeltar te paguar. Gjate vitit 2013 dhe aktualishte shoqeria eshte ende ne proces likuidimi.

15.d. Llogari/kerkesa te arketueshme afatgjata.

Ne kete post paraqiten huate e dhena nga shoqeria te treteve si dhe llogari te tjera te arketueshme afatgjata nga te tretet (klienta, debitore,etj.) . Ky post paraqitet me balancat si meposhte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Llogari / Kërkesa te arkëtueshme afatgjata	268,376,401	137,967,726

## 16. Aktive Afatgjata Materiale (AAM).

### *Njohja dhe matja*

Aktivet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjen e aktiveve të ndryshme dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat përmblendhëse të tjera në lidhje fitime apo humbje të flukseve të parasë të kualifikuara nga mbulimi për blerjen e pronave dhe paisjeve. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse të funksionalitetit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje.

Në momentin që një nga aktivitetet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato regjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve materiale përcaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitetit dhe njihet neto në të ardhura ose humbje të tjera.

### *Kostot në vijim*

Kostot për zëvendësimin e një aktivi regjistrohen me vlerën kontabël të aktivitetit në rast se është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të, të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël e pjesëve të ndërtuara si rrjedhojë ç'rregjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve rregjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndodhin.

### *Amortizimi*

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme e cila është kostoja e aktivitetit ose cdo kosto tjetër zëvendësuese minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën përmblendhëse e të ardhurave bazuar në metodën e vlerës së mbetur për paisjet e zyrës me një normë amortizimi vjetore prej 20%, për paisjet informatike 25% dhe për makinat e transportit 20% dhe me 5% për ndërtesat, prone e shoqërisë. Kjo mënyrë pasqyron më përafërsisht trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive.

Përmirësimet e aktiveve të marra me qera amortizohen mbi 20 vjet. Aktivitetet në proces nuk amortizohen.

Normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura, nëse janë të rëndësishme, aktivitetet afatgjata materiale rivlerësohen në datën e raportimit.



Ky post eshte i detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>16 Aktive Afatgjata Materiale</b>	<b>1,575,442,556</b>	<b>1,609,632,751</b>
a) Toka	300,198,000	300,198,000
b) Ndertesa	1,123,432,499	1,186,704,078
1.Ndertesa QTU	1,510,811,823	1,516,255,914
3.Minus Amortizimi	(387,379,324)	(329,551,836)
c) Makineri dhe paisje	62,159,136	35,265,107
1.Instalime teknike ,makineri e paisje	129,405,980	92,038,670
3.Minus Amortizimi	(67,246,845)	(56,773,563)
d) AAM te tjera	89,652,921	87,465,565
1.Mjete transporti	106,691,512	114,527,046
3.Mobilje dhe orendi	30,288,187	15,629,010
4.Paisje Zyre informatike	17,226,229	14,250,880
5.Te tjera	17,398,313	19,199,104
6.Minus Amortizimi	(81,951,321)	(76,140,475)

## B. PASIVET

### 17. Huamarrjet.

Ky post perfaqeson huamarrjet bankare afatshkurtra pjesen e principalit te huave bankare afatgjata qe maturohen brenda nje periudhe 12 mujore dhe huave te tjera te marra nga shoqeria prej kompanive te grupit. Ne fund te vitit 2013 ky post rezulton ne vleren 2,601,912,069 lek.

Gjendjet e huamarrjeve afatshkurtra ne fund te vitit ushtrimor paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>17 Huamarrjet Afatshkurtra</b>	<b>2,601,912,069</b>	<b>2,497,927,850</b>
a) Paradhenie bankare (Overdraft)	113,790,667	307,727,450
b) Hua bankare - Afatshkurtra	1,448,735,731	1,844,678,631
a) Interesa te perlllogarituara per huamarrjet	2,381,009	21,847,031
a) Huamarje nga ortaku (Balfin)	1,037,004,662	323,674,738

### 18. Huate dhe parapagimet

18.a. Te pagueshme ndaj furnitorëve ne 31 Dhjetor 2013 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>Te pagueshme ndaj furnitorëve</b>	<b>1,370,145,734</b>	<b>1,452,768,550</b>
Furnitore per mallra	8,419,338	2,160,236
Furnitor per sherbime	98,067,067	101,356,837
Furnitor per materiale	1,244,345,904	1,195,232,135
Furnitore per aktivet afatgjate	19,313,425	77,376,717
Kliente me balance kreditore	-	76,642,625

18.b. Te pagueshme ndaj punonjësve jane diferenca nga pagat e punonjesve te papaguara ne fund te vitit ushtrimor ne 31 Dhjetor 2013 rezultojne si me poshte

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Te pagueshme ndaj punonjësve	135,448	31,387

18.c. Detyrimet tatimore perbehen si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>Detyrime Tatimore</b>	<b>106,911,230</b>	<b>2,460,773</b>
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	1,613,125	1,741,254
Tatim taksa mbi te ardhurat personale	630,792	719,519
TVSH per tu paguar/Te tjera	8,541,545	
Detyrimi per Tatim fitimi 2013	96,125,768	

18.d. Ne postin Hua të tjera jane detyrime e shoqerise ndaj paleve te treta si dhe llogari te tjera te pagueshme.

Ne 31 Dhjetor 2013 ky post perbehet si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Hua të tjera	17,483,287	68,212,068

#### 18.e. Parapagimet e arketuara.

Ne kete post paraqiten detyrimet (Parapagime te marra) qe i kane lindur shoqerise nga te tretet per kryerjen e sherbimeve dhe shitjen e apartamenteve ne te ardhmen afatshkurter. Ato jane te detajuara ne tabelen me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>Parapagime te arketuara nga klientet</b>	<b>6,808,564</b>	<b>540,957,113</b>
Projekti Tirana East Gate	-	574,645
Pallati Ambasador 2	-	540,382,468
Parapagime per investime te tjera	6,808,564	

#### 19. Grandet dhe te ardhurat e shtyra

Ne bilancin kontabel te vitit 2013, shoqeria ka gjendje grande dhe te ardhura te shyra ne vleren 7,558,160 lek ne fund te vitit ushtrimor. Ato paraqiten te detajuara si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>Grande dhe te ardhura te shtyra afatshkurtra</b>	<b>7,558,160</b>	<b>4,900,140</b>
Shpenzime te llogaritura	7,558,160	4,900,140

#### 20. Huate afatgjata

Ne kete post paraqiten detyrimet e shoqerise te cilat klasifikohen si detyrime afatgjata.

20.a. Gjendjet e huave dhe qerave financiare te poshteshenuara ne fund te vitit ushtrimor jane paraqitur me vleren nominale te shumes per t'u paguar. Perfaqeson balancen afatgjate te principalit per huate bankare, dhe te qerave financiare te perfituara nga shoqeria. Ato jepen si ne tabelen me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>Huamarrje Afatgjata</b>	<b>245,053,713</b>	<b>568,908,535</b>
Hua bankare - Afatgjata	227,097,145	544,073,105
Kosto financiare te shtyera	(3,492,003)	(3,951,081)
Qera financiare	21,448,571	28,786,511

**21. Huamarrje te tjera afatgjata**

Ne bilancin kontabel te vitit 2013, shoqeria ka gjendje huamarrje te tjera afatgjata qe perfaqesojne detyrimet ndaj ortakut te meparshem te shoqerise, Z. Samir Mane, dhe detyrime ndaj paleve te lidhura.

Me 31 Dhjetor 2013 ky post perbehet si me poshte;

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Huamarrje të tjera afatgjata	819,467,852	853,541,930

**22. Grande dhe te ardhurat e shtyra**

Ne bilancin kontabel te viti 2013, shoqeria ka gjendje Grande dhe te ardhura te shtyra e cila perfaqeson parapagime te arketura nga klientet e projekteve afatgjata te investimit qe do te njihen si te ardhura pas nje periudhe 12 mujore nga data e mbylljes se bilancit.

Ato jepen te detajuara si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>Grande dhe te ardhura te shtyra afatgjata</b>	<b>3,165,075,687</b>	<b>2,956,729,979</b>
Parapagime nga kliente - Projekti i Vilave Lunder	3,161,141,016	2,952,800,323
Depozita garancie nga qeramarres ne QTU	3,934,671	3,929,656

**C. KAPITALI**

**23. Aksionet e pakices.**

Ky post perdoret vetem ne rastin e ndertimit te PF te konsoliduara. Pasqyrat Financiare jane te pakonsoliduara (individuale), prandaj ne kete post nuk paraqitet gjendje ne fund te vitit ushtrimor.

**24. Kapitali qe i perket shoqerise mëmë.**

Ky post perdoret vetem ne rastin e ndertimit te PF te konsoliduara. Pasqyra Financiare jane te pakonsoliduara (individuale), prandaj ne kete post nuk paraqitet gjendje ne fund te vitit ushtrimor. Drejtimi ka marre vendimin qe pasqyrat e konsoliduara do te paraqiten vetem nga aksioneri kryesor Balfin.

**25. Kapitali aksionar.**

Ne kete post paraqitet kapitali me vlere nominale i kontribuar nga ortakut. Ne fund te vitit ushtrimor, kjo vlere kapitali e kontribuar dhe paguar nga ortakut i vetem i shoqerise eshte 689,750,000 lek. Levizjet e kapitalit gjate vitit ushtrimor jane te shprehura ne pasqyren perkatese financiare bashkangjitur ketu.

**26. Rezerva ligjore.**

Ne kete post paraqiten rezervimet e e kryera nga shoqeria , te cilat ne fund te vitin ushtrimor ka vleren 756,000 lek.

## 27. Rezerva te tjera

Ky post paraqet i rritur krahasur me mbylljen e vitit 2012 me shumen e fitimit te pashperndare ne fund te viti kontabel 2012 ne vleren 371,130,768 leke ne rezerva te kompanise ne baze te vendimit te marre nga ortaku i vetem Balfin Shpk pas mbylljes se pasqyrave financiare vjetore si dhe rezervat e krijuara nga rivleresimi i pasurive te paluajtshme.

Ky post paraqitet i detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>Rezerva te tjera</b>	<b>1,589,261,274</b>	<b>1,218,130,506</b>
Rezerva te tjera	1,375,947,628	1,004,816,860
Rezerva nga rivleresimi	213,313,646	213,313,646

## 28. Fitimet e pashperndara

Ne kete post paraqiten fitimet ose humbjet qe shoqeria ka akumuluar nga periudhat paraardhese dhe qe nuk jane perdorur per qellime te caktuara. Ne fund te vitit ushtrimor, ky post nuk ka pasur ndryshime paraqitet me vlere te njejte me vitin paraardhes 3,358,785 lek. Kjo vlere u krijua si rezultat a) Rimarrjes se rezervave te rivleresimit b) rivleresimin i tatim fitimit per vitet 2009-2011 ne baze te raport kontrollit tatimor.

Rimarrja e rezervave te rivleresimit lidhet me efektin e rivleresimit te tokes se shitur pas rivleresimit sipas shpjegimit ne Shenimin nr. 16.

Efekti i aplikimit te SNK-ve ndikojne ne ulje te fitimit te pashperndare ne vleren 128,225,982 lek. Kjo si rezultat i rimarrjes se Marzhit te fitimit qe shoqeria ka njohur per projektet te cilat jane pjese e inventarit te shoqerise.

## 28. Fitimi (Humbja) e vitit financiar.

Ne kete post paraqitet fitimi ose humbja e periudhes ushtrimore te shoqerise ashtu si rezulton ne PASH, pasi eshte zbritur tatim fitimi i llogaritur ne vlere 10%. Per vitin ushtrimor 2013 fitimi i vitit financiar eshte ne vlere neto 1,104,513,824 lek.

## 29. Palet e lidhura

Shoqeria ka marrëdhënie me palë të lidhura me shoqërinë mëmë (Balfin sh.p.k) dhe kompanitë e saj. Një numër transaksionesh janë të lidhura me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Këto transaksione janë kryer në terma tregtare dhe në normat e tregut.

Ne shtojcat bashkelidhur janë palët e lidhura me ManeTCI sh.p.k dhe marrëdhëniet e tyre respektive deri më 31 Dhjetor 2013.

### 2.3 Ngjarjet pas dates se Bilancit Kontabel

Pas dates se bilancit kontabel kane ndodhur ngjarje qe kane ndikuar ne rezultatin financiar te vitit ushtrimor. Ato jane si me poshte:

- a) Per objektin Qendra Tregtare Univers – QTU, shpenzimet e perbashketa te dyqaneve per muajin Dhjetor 2013, i jane faturuar qeramarrsesve ne muajin Janar 2014. Per kete arsye, eshte sistemuar zeri „Te ardhura te tjera“ duke u rritur me shumen 4,997,718.92 lek
- b) Per objektin Qendra Tregtare Univers – QTU, faturat per konsumin e energjise elektrike te dyqaneve per muajin Dhjetor 2013, kane ardhur dhe jane regjistruar ne Janar 2014. Per kete arsye, eshte sistemuar zeri „Mallra, lende te para dhe sherbime“ duke u rritur me shumen 4,593,830.5 lek;
- c) Per kantjeret e ndertimit ku shoqeria ushtron aktivitetin e saj, faturat per konsumin e energjise elektrike dhe furnizimin me uje per muajin Dhjetor 2013, kane ardhur dhe jane regjistruar ne Janar 2014. Per kete arsye, eshte sistemuar zeri „Mallra, lende te para dhe sherbime“ duke u rritur me shumen totale prej 730,896 lek;
- d) Faturat e kompanive te telefonise fikse dhe celulare per shpenzimet e telefonise te muajit Dhjetor 2013, jane marre dhe regjistruar me date Janar 2014. Vlera prej 362,290 leke eshte njohur si shpenzim i periudhes duke rritur zerin „Shpenzime telekomunikacioni dhe poste“;
- e) Ne periudhen Shkurt Mars 2014 ndaj shoqerise u ushtrua kontroll nga Organet Tatimore dhe efektet e tij nuk jane materiale.

**Shoqeria “MANE TCI “ Sh.p.k.**

Drejtor i përgjithshëm

Drejtor i departamentit të financës

**Arben MEMO**

**Elisabeta HAJRULLI/AI**

**Tirane me 15 Mars 2014**



## LEGJENDA

1	SHTOJCA A	Paga dhe Sigurime per vitin 2013
2	SHTOJCA B	Tabela e Amortizimit
3	SHTOJCA C	Kliente - Gjendje Analitike
4	SHTOJCA D	Lista e Mjeteve te Transportit
5	SHTOJCA E	Furnitore - Gjendje Analitike
6	SHTOJCA F	Kontratat e qeramareseve per vitin 203
7	SHTOJCA G	Palet e Lidhura
8	SHTOJCA H	Lista e Zhdoganimeve
9	SHTOJCA J	Deklarata Tatim Fitimi 2013
10	SHTOJCA L	Lista e Detajuar e Aseteve
11	SHTOJCA M	Lista e detajuar e Materialeve
12	SHTOJCA N	Pasqyra statistikore Nr. 1 (Te Ardhurat)
13	SHTOJCA O	Pasqyra statistikore Nr. 2 (Shpenzimet)
14	SHTOJCA P	Pasqyra statistikore Nr. 3 (Aktiviteti)

List pagesa e kontributeve te sigurimeve shoqerore, shendetore & Tatimit mbi te Ardhurat nga punesimi  
Periudha tatimore 2013

MANE TCI : K22203004A

Nr	6) Muaji	NR/PUNJ	Paga bruto ne leke		Kontribute per sigurimet shoqerore ne leke				16) Kontribute per sigurimet shendetore gjithsej ne leke	17) Paga bruto mbi te cilen llogaritet Tatimi mbi te ardhurat nga punesimi	18) Tatimi mbi te ardhurat nga punesimi ne leke	PAGA NETO
			Gjithsej	11) Mbi te cilen llogariten kontributet	12) Gjithsej = (13 + 14 + 15)	Nga keto:		15) Kontribut shitese				
			9) Dite kalendarike te punuarit te subiektit eplate munit									
			13) Pundhensia									
			14) Pundhensia									
1	JANAR	114	7,483,051	6,126,171	1,500,912	918,926	581,986	0	208,290	7,483,051	711,105	6,085,815
